



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr. 1427/18 datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

-III- Nr. prot. 1798 Më Dt. 05.06 2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda Komunës së Rahovecit dhe që fushëveprimtari kanë kulturën dhe rininë, të aplikojnë për mbështetje financiare nga subvencionet për Kulturë dhe Rini.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për individë dhe OJQ-të kulturore dhe rinore për zhvillimin e aktiviteteve nga fushëveprimtaria e tyre si dhe për Organizatat e dala nga lufta:

1. Kultura – në kuadër të të cilës përfshihen këto projekte:

- Promovimi i vlerave kulturore.
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike.
- Promovimi i vlerave të festivaleve, koncerteve, teatrove, filmit, pikturave, skulpturave.
- Grupet artistike (shoqëritë dhe individët).
- Promovimi i solistëve, aktorëve, këngëtarëve, artistëve, etj.
- Promovimi i vlerave artizanale.
- Promovimi i botimeve të librave dhe ekspozitave.
- Aktivitete tradicionale kulturore.

2. Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së të cilat ruajnë dhe promovojnë vlerat historike, kombëtare dhe të trashëgimisë kulturore e kombëtare.

3. Rinia – në kuadër të së cilës bëjnë pjesë këto projekte:

- Promovimi i talentëve të rinj
- Infrastruktura për rini
- Edukimi joformal i të rinjve
- Punësimi i të rinjve
- Aktivitete rinore sportive, etj.

Specifikat tjera të thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 05.06.2020 dhe mbyllet më 25.06.2020.**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ, që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë në mes të përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit.
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ-të
- Çertifikata me numër fiskal
- Çertifikata me numër të regjistrimit të biznesit
- Kopja e kartelës së xhirollogarisë në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar.
- Vërtetim nga DKRS, për dorëzimin e raportit financiar nga subvencionet e vitit paraprak.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit original të kërkuara si dhe kopja elektronike në CD,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.

